



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM
nr. 406, datë 01.03.2016

“Për
disa rekomandime mbi projekt/ligjin “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪ Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪ Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva	ZAJMI	Anëtar
▪ Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.03.2016, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me projekt-ligjin “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

Baza ligjore: Neni 24, germa f), neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar)

Komisioni i Konkurrencës pasi mori në shqyrtim relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi vlerësimin e projekt-ligjit “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës ka ardhur për mendim nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës projekt/ligji “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.
2. Nga vlerësimi i projekt/ligjit rezultoi se: Ky projekt ligj synon krijimin e një kuadri të favorshëm dhe të qëndrueshëm ligjor për nxitjen dhe zhvillimin e transportit hekurudhor bashkëkohor në territorin e Republikës së Shqipërisë, zhvillimin e një transporti hekurudhor efikas dhe konkurrues me mënyrat e tjera të transportit, duke krijuar kushtet që sipërmarrësit hekurudhorë të kenë statusin e operatorëve të pavarur, të sillen në mënyrë komerciale dhe të përshtaten me nevojat e tregut.
3. Në projekt/ligj sanksionohen parimet: e pavarësisë së sipërmarrësve hekurudhorë; të detyrimit për mbajtjen e llogarive të veçanta sipas veprimtarive që ata kryejnë; pavarësia nga çdo sipërmarrës hekurudhor e njësisë administrative që do të merret me ndarjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe me caktimin e tarifës/pagesës për shfrytëzim të infrastrukturës; garantimi i aksesit të çdo transportuesi hekurudhor në infrastrukturë dhe shërbime hekurudhore), parime të cilat kanë për qëllim krijimin e kushteve favorizuese për konkurrencën në tregun hekurudhor.

4. Kapacitetet e infrastrukturës përcaktohen dhe jepen në përdorim nga Administratori i Infrastrukturës Hekurudhore. Ai është përgjegjës për zbatimin e skemës së shpërndarjes së kapaciteteve të shfrytëzimit të infrastrukturës të hartuar prej tij dhe të konsultuar me Organin Rregullator Hekurudhor.
5. Kërkesat për kapacitete të infrastrukturës hekurudhore bëhen nga kërkuesit e kapaciteteve infrastrukturore hekurudhore drejtpërdrejt tek Administratori i Infrastrukturës Hekurudhore. Ky i fundit vendos kriteret që kërkuesi i kapacitetit infrastrukturor hekurudhor duhet të përmbushë. Administratori i Infrastrukturës shpall të gjitha karakteristikat dhe kushtet/kriteret e shfrytëzimit të infrastrukturës në një dokument që quhet Deklarata e Rrjetit. Kriteret e përcaktuara në këtë deklaratë duhet të jenë të përshtatshme, transparente e jo diskriminuese.
6. Ky dokument përmban edhe mënyrën e përlllogaritjes së tarifës paguese për përdorim infrastrukturë, dhe garantohe në kontrollin e tij nga Organi Rregullator i Tregut, i cili ruan rregullat e tregut për mos diskriminim. Struktura e përlllogaritjes së tarifave të përdorimit të infrastrukturës hekurudhore, përcaktohet dhe miratohet nga Ministria që mbulon veprimtarinë e transportit në bashkëpunim me autoritetet kompetente në vend.
7. Për përdorimin e kapacitetit në infrastrukturën hekurudhore përkatëse Administratori i Infrastrukturës Hekurudhore dhe kërkuesi i kapacitetit lidhin një Marrëveshje Kuadër në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet përkatëse të Administratorit të Infrastrukturës Hekurudhore dhe të kërkuesve të kapacitetit infrastrukturor në lidhje me shpërndarjen e kapaciteteve infrastrukturore hekurudhore. Marrëveshja kuadër miratohet parapakisht nga Autoriteti Rregullator.
8. Për sa më sipër Administratori i Infrastrukturës ka një pozitë dominuese në infrastrukturën që ai administron. Në këto kushte ai ka detyrimin të respektojë të drejtën e barazisë për operatorët që do të kryejnë shërbimet e transportit të mallrave/udhëtarëve duke shfrytëzuar/përdorur infrastrukturën hekurudhore përkatëse dhe të mosabuzimit me të. Me qëllim shmangien dhe parandalimin e sjelljeve antikonkurrese nga Administratori i Infrastrukturës, është e nevojshme marrja e mendimit të Autoritetit të Konkurrencës për çdo marrëveshje kuadër të lidhur para miratimit të tyre nga Autoriteti Rregullator.
9. Organi rregullator si organ i përfshirë drejtpërdrejt në rregullimin e tregut hekurudhor, ka kompetenca të gjera mbi aktorët e këtij tregu. Si i tillë, rezultatet e monitorimeve të bëra prej tij si dhe masat e vendosura prej tij për sigurimin e konkurrencës në tregun e shërbimit hekurudhor, duhet të përcillen në AK për procedime të mëtejshme si organi kompetent në fushën e konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f), nenin 69, pika 1, dhe nenin 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. T'i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës implementimin në projekt/ligjin "Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" të shtesave të mëposhtme:
 - a) Në nenin 42, pas pikës 3 të shtohet një pikë me përmbajtje si vijon:

"Autoriteti Rregullator Hekurudhor para miratimit të çdo Marrëveshje/Kontrate koncesionare ose dhënie e të drejtave ekskluzive merr paraprakisht edhe mendimin e Autoritetit të Konkurrencës".
 - b) Në nenin 55 të bëhen shtesat e mëposhtme:
 - Në pikën 2 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur organi rregullator vëren shenja të një sjelljeje antikonkurrese nga sipërmarrësit hekurudhorë në tregjet e shërbimeve hekurudhore, e përcjell rastin pranë Autoritetit të Konkurrencës, duke i vënë në dispozicion gjithë informacionin përkatës."
 - Në fund të pikës 10 të shtohet fjalia:

" Në çdo rast Organi Rregullator njofton edhe Autoritetin e Konkurrencës."
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA
(_____)
Zv/Kryetar

Koço BROKA
(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI
(_____)
Anëtar

Eduard YPI
(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R